

# SI MËSOJNË NXËNËSIT

## **Përmes asosacioneve**

Nxënësit do të përpiqen të lidhin informacionin e ri që marrin me njohuritë që ato tashmë i kanë. Informacioni i ri mbahet më lehtë nëse një person ka njohuri të mëparshme mbi të cilat të shtojë të tjera. Prandaj, nëse ju mund të lidhni informacionin e ri me njohuri që grupi ka pasur më përpara, ato do të mbajnë një përqindje më të lartë të atij informacioni.

## **Përmes hamendësimeve**

Nëse ka boshllëqe në informacionin e dhënë, njerëzit do të bëjnë hamendësime në lidhje me atë që duhet të mbushë atë boshllëk, bazuar në njohuritë e tyre të mëparshme.

Ju duhet të siguroheni që nuk jeni duke lënë hapësirë për hamendësime nga grupi dhe që të mos bëni hamendësime për nivelin e tyre të njohurive.

## **I pari dhe i fundit**

Njerëzit mbajnë mend gjënë që dëgjojnë të parën dhe atë të fundit.

*Strukturoni të mësuarit e tyre në këtë mënyrë:*

- ✓ Shpjegoni se për çfarë do të flisni;
- ✓ Flisni për atë që keni për të folur;
- ✓ Përmbliidhni atë që keni thënë.

## **Përmes Copëzave/Të pasurit kuptim**

Me qëllim për të mbajtur informacionin , mendja jonë e ndan atë informacion në 'copëza'. Kjo lehtëson mbajtjen e informacionit për arsye se informacioni ka kuptim.

## **Përmes logjikës**

Ju duhet ta bëni logjik informacionin e ri për nxënësin për ndryshe ato do të bëjnë hamendësimet e tyre. Me qëllim për ta bërë një gjë të tillë ju duhet të paraqitni informacionin në copëza të vogla duke e vënë atë në një sekuencë logjike me qëllim që ai të kuptohet lehtësisht.

## **Përmes përdorimit të rregullt**

Individët kanë më shumë gjasa që të mbajnë mend informacionin nëse ai jepet në një gjuhë që ato e kuptojnë dhe që është e lehtë për të bërë një lidhje. Prandaj, nëse keni një çështje komplekse për të diskutuar, lidheni atë me diçka që ndodh në jetën e përditshme.

## **Përmes shqisave**

*Ne marrim informacion duke përdorur të gjitha shqisat, p.sh:*

- Të shikuarit 70%;
- Të dëgjuarit 15%;
- Prekja 10%;
- Të shijuarit 3%;
- Të nuhaturit 2%.

Sa më shumë nga këto që të përdoren, aq më e lartë do të jetë mbajtja e informacionit.

### METODAT E MËSIMDHËNIES

Metoda	Avantazhet	Disavantazhet
Leksionet (mësuesi)	Të dobishme për informacion praktik	Shprehje e pikëpamjeve vetëm nga një person Përfshirje e ulët
Bisedimet (vizitorët)	Të dobishme për informacion praktik	Shprehje e pikëpamjeve vetëm nga një person Përfshirje e ulët
Diskutimet në grup	Të dobishme për nxjerrjen e ideve dhe zgjidhjeve	Kërkon pjesëmarrje të përshtatshme, punë në grup dhe moderim.
Ushtrimet me luajtje rolesh	Të dobishme për zhvillimin e aftësive sociale	Kërkohet organizim i kujdesshëm
Ushtrimet me zhvillimin e aftësive	Një mënyrë e sigurt për të praktikuar aftësitë kyçe	Kërkohet organizim i kujdesshëm
Projektet e udhëhequra	Rrit njohuritë dhe aftësitë në situatën e punës	Gjetja e drejtuesve të përshtatshëm
Këshillimi (intervistat një-nga një)	Nxënësi ka nevojë për ndihmë dhe ajo i ofrohet	Aftësitë këshilluese duhet të zhvillohen


### STILET E TË MËSUARIT

*(Stilet e të mësuarit të Honey dhe Mumford)*

<b>AKTIVISTËT</b>	<p>Këto njerëz kënaqen me të tashmen dhe janë të dominuar nga eksperiencat aktuale. Ata/Ato kanë një tendencë të shijojnë krizat afat-shkurtra dhe zgjidhjen e problemeve imediate. Ndërsa kur i del përpara sfida e një eksperience të re ato shpejt mërziten dhe nuk pëlqejnë implementimin apo angazhimet afat-gjatë. Ata/Ato kënaqen duke punuar me të tjerët por kanë një tendencë të dominojnë, duke bërë gjithçka vetë dhe duke pushtuar kështu të gjithë qendrën e vëmendjes.</p> <p><b>Stili i të mësuarit</b> Ata kanë tendencë të mësojnë më mirë nga aktivitete me kohë relativisht të shkurtër që përfshijnë detyra ku ata kanë një angazhim relativisht të menjëhershëm. Gjatë ciklit të të mësuarit ata janë gati të përfshihen në shkallën e parë por më pak të gatshëm ta përfundojnë apo rishikojnë atë. Ata/Ato kanë tendencë të jenë nxënës me intuitë të cilët nuk pëlqejnë të dëgjojnë leksione se si t'i bëjnë gjërat apo të ndjekin udhëzime të shkruara në letër.</p>
<b>REFLEKTUESIT</b>	<p>Reflektuesit pëlqejnë të rrinë ulur dhe të vëzhgojnë, të mbledhin të dhëna dhe t'i mendojnë gjatë gjërave. Ata/Ato janë të kujdesshëm dhe metodik dhe analizojnë gjërat me kujdes përpara se të arrijnë në përfundime. Ato mund të jenë shumë të kujdesshëm, duke analizuar një situatë nga të gjitha anët e mundshme për t'u përpjekur dhe për të eliminuar të gjitha rreziqet.</p> <p><b>Stili i të mësuarit</b> Në ciklin e të mësuarit ata janë zakonisht më efektivë në shkallën e rishikimit dhe kanë tendencë të përshtatin një qasje më reflektuese. Ata/Ato preferojnë të ulen në sedilen e pasme në diskutim dhe të kënaqen duke dëgjuar të tjerët përpara se të flasin vetë. Ata/Ato kanë tendencë të bëjnë më të mirën e mundshme në aktivitete të të mësuarit</p>

	ku ata/ato mund të përfshihen në punë kërkimore përpara se të veprojnë dhe nuk pëlqejnë nëse nxiten të jenë në qendër të vëmendjes duke i bërë lider ose i kërkohet të bëjnë një prezantim kur nuk kanë kohë të përgatiten.
<b>TEORICIENËT</b>	<p>Teoricienët pëlqejnë të analizojnë ose sintetizojnë, të prodhojnë modele dhe sisteme të cilat sistemojnë fakte të ndryshme dhe t'i përshtatin ato në skema racionale. Ata/Ato pëlqejnë të punojnë me situatat hap pas hapi. Ata/Ato kanë tendencë të jenë perfeksionistë dhe refuzojnë çdo gjë që është intuitive dhe që nuk përshtatet me qasjen e tyre logjike.</p> <p><b>Stili i të mësuarit</b> Për sa i përket ciklit të të mësuarit ata/ato dalin më mirë në shkallën përfundimtare dhe mund të mësojnë si nga tipat e të mësuarit reaktive ashtu edhe nga ato proaktive. Ata/Ato janë të ngjashëm me reflektuesit por vënë një theks më të madh tek nevoja për t'a vënë të mësuarin e tyre në një kontekst të një modeli ose teorie. Ato mund të mos ndjehen rehat nëse aktiviteti nuk është i strukturuar mirë ose është i prezantuar në një mënyrë të çorganizuar ose kur ato nuk janë rehat për sa i përket anës intelektuale.</p>
<b>PRAGMATISTËT</b>	<p>Pragmatistët janë të interesuar në eksperimentimin duke aplikuar teknika të reja. Ata/Ato janë tipi i personit që vijnë nga kurset dhe duan t'i provojnë idetë e reja menjëherë. Ata janë shumë rehat me gjëra që duken sikur do të funksionojnë dhe kanë tendencë të refuzojnë idetë që nuk kanë një zgjidhje të dukshme. Ata/Ato pëlqejnë t'i realizojnë gjërat dhe të veprojnë shpejt dhe me besim në vetvete dhe kanë një tendencë të zgjedhin zgjidhjen e parë.</p> <p><b>Stili i të mësuarit</b> Në lidhje me ciklin e të mësuarit, ata/ato pëlqejnë shkallën e planifikimit sepse kjo adreson veprim praktik. Ata/Ato kanë ngjashmëri me aktivistët por ndryshojnë në pjesën që ato mësojnë më mirë kur shohin një lidhje të qartë midis subjektit dhe problemit. Ato kanë një tendencë të përshtaten me qasjen proaktive e cila plotëson interesin e tyre në planifikim. Ata/Ato kanë nevojë për ngjarje ku i jepet mundësia të provojnë aftësitë që kanë dhe të marrin opinione.</p>

## MBËSHTETJA E NXËNËSVE ME NEVOJA TË NDRYSHME



Disa nxënës kanë nevojë për mbështetje shtesë që do t'i ndihmonte ata të mësonin dhe arrinin qëllimet e tyre të karrierës. Të gjithë nxënësit kanë nevojë të kenë mundësi të ndjekin orët e mësimi të lëndës së edukimit për karrierën, disa mund të kenë nevojë për mbështetje shtesë për të arritur qëllimet e të mësuarit ndërsa pak prej tyre mund të kenë

nevojë që t'i drejtohen psikologëve ose mund të kenë nevojë për këshillim ose orientim një-nga-një nga mësuesit.

**E GJELBËR:** Orët e mësimi të Edukimit për Karrierën për të gjithë nxënësit

**PORTOKALLE:** Orët e Mësimi të Edukimit për Karrierën - diferencimi i nxënësve në klasë për të siguruar që të gjithë nxënësit kuptojnë qëllimet e të mësuarit (metodat e mësimdhënies)

**E KUQE:** Ato nxënës që nuk janë të sigurt për qëllimet e tyre të karrierës, kanë pengesa (sociale ose ekonomike) për të arritur qëllimet e tyre mund të kenë nevojë për këshillim dhe orientim një-nga-një ose nga mësuesi ose nga psikologu i shkollës.

Atë që dëgjoj ...

**E HARROJ**

Atë që shoh ...

**E MBAJ MEND**

Atë që bëj ...

**E KUPTOJ**

*Confucius*